



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 2789/20 prot.

Tiranë, më 24. 11. 2023

Lënda: Njoftim për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Ken Dhima, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje

Z. ASTRIT SHPUZA

E-mail: astritshpuza@gmail.com

Në mbështetje të nenit 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 134 dhe nenin 138 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në cilësinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, po ju paraqes njoftimin për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Ken Dhima, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje

Bashkëlidhur njoftimit do të gjeni Vendimin për Përfundimin e Hetimit Disiplinor.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 2789/17 prot.

Tiranë, më 24.11.2023

VENDIM

“PËR

**PËR PËRFUNDIMIN E HETIMIT DISIPLINOR NDAJ MAGJISTRATIT
KEN DHIMA, ME DETYRË GJYQJAR NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË
SHKALLËS SË PARË LUSHNJE DHE MBYLLJEN E HETIMIT DISIPLINOR
NDAJ ISH-MAGJISTRATIT ROLAND HYSI, ME DETYRË GJYQJAR NË
GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR FIER, NË KOHËN KUR KA NDODHUR
SHKELJA E PRETENDUAR”**

Në mbështetje të neneve 133, 134 dhe 138 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 204, pika 7, shkronja “a” dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Raportit të datës 19.12.2022, të inspektorese përgjegjëse Alma Tafani “Për hetimin disiplinor me iniciativë ndaj magjistratit Ken Dhima, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe ish-magjistratit Roland Hysi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar” ;

KONSTATOVA SE

1. Me vendimit të ish-IKLD me nr. 1245/3, datë 14.06.2018, “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Ken Dhima”, vendimit nr. 4274/3 prot., datë 31.03.2022 “Për verifikimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga z. Ulsi Manja, Ministër i Drejtësisë”, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendimit me nr. 105/1, datë 09.02.2023 “Për vazhdimin e hetimit disiplinor ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit Ken Dhima, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë” të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendimit me nr. 919/5 prot., datë 16.03.2023 “Për bashkimin e praktikave të verifikimit dhe hetimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit Ken Dhima, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendimit nr. 105/7, datë 18.04.2023 “Për zgjatjen e afatit të zhvillimit të hetimit disiplinor ndaj magjistratit Ken Dhima, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendimit nr. 105/16, datë 09.06.2023 “Për zgjatjen e



afatit të zhvillimit të hetimit disiplinor ndaj magjistratit Ken Dhima, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendimit nr. 105/21, datë 10.10.2023 “Për zgjatjen e afatit të zhvillimit të hetimit disiplinor ndaj magjistratit Ken Dhima, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, vendimit nr. 2789/1 prot., datë 27.09.2023, “Për vazhdimin e hetimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit Ken Dhima gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe magjistratit Roland Hysi, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier” dhe vendimit nr. 2789/10 prot., datë 02.11.2023 “Për bashkimin e procedimeve hetimore, ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë Ken Dhima”, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 102, pika 1, shkronja “d”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Nga hetimi disiplinor i kryer ndaj veprimtarisë së magjistratit Ken Dhima, si dhe nga analiza ligjore e fakteve dhe rrethanave të hetuara, provohet kryerja e shkeljes disiplinore për të cilën ka filluar hetimi disiplinor, ajo e parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar
3. Në përfundim të procedurës së hetimit disiplinor ndaj magjistratit Ken Dhima, nga ana e inspektorit përgjegjës, është propozuar fillimi i procedimit disiplinor për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 102, pika 1, shkronja “d”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe caktimin ndaj tij të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” të parashikuar nga neni 111, i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
4. Raporti i hetimit disiplinor, në lidhje me magjistrarin Ken Dhima vlerësohet të jetë i plotë në formë dhe në përmbajtje. Faktet e konstatuara dhe analiza ligjore e tyre në drejtim të identifikimit të elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë kryerjen e shkeljes disiplinore, si dhe nuk diktojnë mbylljen e hetimit disiplinor, mbi rëndësinë e shkeljes disiplinore dhe llojin e masës disiplinore, janë të plota. Propozimet e inspektorit përgjegjës në përfundim të raportit të hetimit, vlerësohen se janë në përputhje të plotë me analizën e këtij raporti, të arsyeshme dhe të bazuara në ligj.
5. Nga hetimi disiplinor i kryer ndaj veprimtarisë së ish- magjistratit Roland Hysi, si dhe nga analiza ligjore e fakteve dhe rrethanave të hetuara, rezulton se në rastin konkret ekzistojnë rrethana faktike dhe/apo element juridik, i cili dikton mbylljen e këtij hetimi disiplinor në mbështetje të parashikimeve të nenit 134, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Sipas kësaj dispozite, “Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin disiplinor, nëse ç) magjistratit



i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat "b" deri në "ç", të pikës 1, të nenit 64¹, të këtij ligji ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji.

6. Në përfundim të procedurës së hetimit disiplinor ndaj ish-magjistratit Roland Hysi, nga ana e inspektorit përgjegjës, është propozuar mbyllja e hetimit disiplinor për magjistratin Roland Hysi, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier² (në kohën e shkeljes së pretenduar).
7. Raporti i hetimit disiplinor, në lidhje me ish-magjistrarin Roland Hysi vlerësohet të jetë i plotë në formë dhe në përmbajtje. Faktet e konstatuara dhe analiza ligjore e tyre në drejtim të identifikimit të elementeve faktikë dhe juridikë të cilat diktojnë mbylljen e hetimit disiplinor, janë të plota. Propozimet e inspektorit përgjegjës në përfundim të raportit të hetimit, vlerësohen se janë në përputhje të plotë me analizën e këtij raporti, të arsyeshme dhe të bazuara në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të neneve 133, 134 dhe 138 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe neneve 194 dhe 214, pika 7, shkronja "a" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar,

VENDOSA

1. Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Ken Dhima, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1 shkronja "d", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në lidhje me Vendimit nr. 1245/3, datë 14.06.2018, të ish-IKLD "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Ken Dhima", Vendimit me nr. 105/1, datë 09.02.2023 "Për vazhdimin e hetimit disiplinor ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit Ken Dhima, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë" të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Vendimit me nr. 919/5 prot., datë 16.03.2023 "Për bashkimin e praktikave të verifikimit dhe hetimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit Ken Dhima, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë", të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Vendimit nr. 2789/1 prot., datë 27.09.2023, "Për vazhdimin e hetimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit Ken Dhima gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe magjistratit Roland Hysi, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier" dhe vendimit nr. 2789/10 prot.,

¹ "Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur shkarkohet nga funksioni"

² Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendim nr. 147, datë 29.3.2023, "Për përcaktimin e kategorive të gjykatave" ka vendosur: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ndryshohet në emërtimin Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.



datë 02.11.2023 “Për bashkimin e procedimeve hetimore, ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë Ken Dhima” të Inspektorit të Lartë të për shkelje shumë të rënda profesionale që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe neni 102, pika 2, shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj Ken Dhima, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 1, shkronja “d”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
4. Njoftimin e magjistratit Ken Dhima me Raportin e Hetimit dhe me vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi përfundimin e hetimit disiplinor ndaj tij.
5. Njoftimin e ankuesve Ministria e Drejtësisë, Astrit Shpuza dhe Nikollaq Deliu me vendimin mbi përfundimin e hetimit disiplinor.
6. Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Roland Hysi, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (në kohën e shkeljes së pretenduar) për shkelje disiplinore të parashikuar në nenin 140, pika 2³, shkronja “b”⁴ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 104⁵ të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për zvarritjen e gjykimit të çështjes penale nr. 71008-00705 (647).
7. Mbylljen e hetimit disiplinor për magjistratin Roland Hysi, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier⁶ (në kohën e shkeljes së pretenduar) për shkelje disiplinore të parashikuar në nenin 140⁷, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 134, pika 1, shkronja “ç” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

³ Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur:

⁴ b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

⁵ Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale

⁶ Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendim nr. 147, datë 29.3.2023, “Për përcaktimin e kategorive të gjykatave” ka vendosur: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ndryshohet në emërtimin Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

⁷ Neni 140 (Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016) 1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. 2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës;



8. Njoftimin e ish-magjistratit Roland Hysi me Raportin e Hetimit dhe me vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi përfundimin e hetimit disiplinor ndaj tij.
9. Dërgimin e Raportit të hetimit disiplinor së bashku me dosjen hetimore pranë institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

